ЦЕНТАР ЗА ИСТРАЖУВАЊЕ И КРЕИРАЊЕ ПОЛИТИКИ

**Analizë NR.1:**

# POLITIKA ETNIKE MAQEDONASE PAS MARVESHJES SË OHRIT - PYETJA RETH LIGJIT TË RI PËR KUFIJTË E VETËQEVERISJES LOKALE

9 gusht, 2005

Shkup, Maqedoni

Центар за Истражување и Креирање на Политики (ЦИКП) е независен и непрофитен истражувачки институт настанат како резултат на потребата од независни, темелни и точни истражувања во областа на применетите (јавните) политики. ЦИКП подготвува анализи и го набљудува процесот на креирање политики во Македонија. Со своите истражувања и објективни анализи базирани на факти и теренски истражувања Центарот се стреми да покрене дебата околу битни социо-економски прашања за Македонија. ЦИКП се состои од група на експерти од земјата, како и надворешни соработници од повеќе Европски земји. Експертите се образовани и имаат искуство во разни области како на пример-политикологија, право, економија, меѓународни односи, и социологија.

ЦИКП цели кон пополнување на јазот помеѓу законските решенија и јавните политики и реалната ситуација преку конкретни анализи како и лобирање (advocacy) на истите. Областите во кои членовите на ЦИКП моментално работат се следниве:

a) Социо-економски Развој на Општините

b) Истражување на Македонската Политичка Сцена преку Студии на Јавното Мнение т.н., Студии Пред и После Избори (national election studies на Универзитетот во Мичиген)

c) Истражувања во Здравството и Здравствената Заштита (финансирање, рационализација на здравствените услуги, и т.н. quality assurance)

d) Социјално Осигурување (пензиски системи)

e) Добро Владеење (мониторинг на децентрализацијата на локално ниво)

f) Градење на Капацитети на НВОа, групи на граѓани и професионални организации преку трениминзи за тоа како се вршат истражувања на јавните политики (policy analysis).

Сметаме дека подготовката на студии на случај за Македонските социо-економски проблеми на микро ниво ќе го помогне процесот на креирање на добри односно квалитетни јавни политики. Исто така, убедени сме дека е повеќе од потребно да се работи на евалуација на јавните политики во различните сектори за истите да бидат подобрени и поблиски до потребите на граѓаните.

Нашите Партнери се:

**European Stability Initiative**
**The German Marshall Fund на Соодинетите американски држави**
**Libertas Институтот**
**Olof Palme Меѓународниот центар**
**Фондација Институт Отворено Општество Македонија**
**Journal of Southeast European Politics**

**PËRMBAJTJA**

Hyrje .......................................................................... 4
Përpunim i ligjit në mënyrë Ballkanike ............................................ 5
Pyetjet më kontraverze dhe reakcionet e publikut .................................. 9
Reakcionet e bashkësisë ndërkombëtarë dhe dështimi i referendumit .........11
Përfundim .......................................................................14

# Hyrje

Ky dokument do ti shqyrtojë ngjarjet e mëparshme në Maqedoni në lidhje me implementimin e marveshjes së Ohrit në sferën e pushtetit të decentralizuar dhe vëmendje  të veçantë i kushtohet ngjarjeve reth referendumit për Ligjin e ri të apruvuar për  ndarje teritoriale. Më 3 shtatorë të vitit 200ç Parlamenti Maqedonas e  aprovoj vendinmin të mbajë referendum  më 7-të Nëntorë. Në rastë se, referendmumi i inicuar nga kongresi Botërorë maqedonas në fillim të vitit 200ç të jetë i sukseshëm, në mënyrë efektive do të kishte anuluar Ligjin e ri të aprovuar. për ndarje të re teritoriale, qyteti i Shkupit dhe financimi i njësive të vetëqeverisjeve lokale  dhe do të kishte rikthyer në status quo anto në 123- komuna.  Ligji i ri zvogloi numrin e komunave në 8ç. Thirja në referendum poashtu shkaktojë edhe anulimin e  zgjedhjeve lokale, të cilat edhe para asaj dhe të ricaktuar  për 21 Nëntorë, kurse tani sipas Ligjit të caktuara më 31 Mars të vitit 2005. Ligji për ndarje teritoriale ishte pjesë a pakos, së nevojshme për sigurimin e procesit të decentralizimit i cili ishte caktuar si komponentë kyçe e Marveshjes Kornizë së Ohrit nga viti 2001. Bashkësia ndërkombëtare tregoj brengosje për ndikimin potencial që referendumi do të kishte ndaj procesit të Ohrit dhe të mardhënëjeve ndëretnike në përgjithsi.

# Përpunim i ligjit në mënyrë Ballkanike

Përpunim i Ligjit për kufijtë e vetëqeverisjes lokale nuk ishte transparente dhe nuk kishte pëlqim nga publiku. Repsektivisht, tre partit anëtarët e koalicionit qeveritarë(Lidhja Social Demokrate(LSDM), Bashkimi Demokratik për Integrim(BDI) dhe Partija Liberal u pajtuan për principet kryesore të Ligjit për ndarje teritoriale pa transparencë dhe përkrahje nga publiku. Bisedimet partiake ndërmjet partnerëve të koalicionit LSDM dhe BDI për shpërndarje të 123- komunat e qeverisjes lokale në Maqedoni ishin mbajtur më qershorë të vitit 200ç në qendrën turistike Mavrovo. Mediumet maqedonase shpallën se nuk kishin qenë të ftuar ekspertë për decentralizim, administratë publike dhe qytetarë, që të marin pjesë në bisedimet. Pas takimit të parë të partnerëve të koalicionit ishte qartë se diskutimi i ndarjes teritoriale do të ngelë në dyert e mbyllura. Në vend se të deklarohen për transparencë dhe diskutim public, bashkësia ndërkombëtare e lejoj këtë pazarllëk në nivel të lartë me kërkesë për zgjidhje më të shpejtë të ngjarjes. Përfaqsuesi i BE në Maqedoni, Shina Tomson deklaroj se ka qenë në kontakt permanent me partnerët e koalicionit dhe se ka dhënë këshilla kur ka qenë e nevojshme, por “gjithçka është në duart e elitës qeveritare”. Në pyetjen për koment për natyrën e mbyllur dhe jotransparente të bisedimeve, zëdhënësi i BE tha se” ata( partnërët e kualicionit) janë të zgjdhur nga ana e popullit “[1]

Kur partitë politike përfundimisht aritën kompromis për kufijtë e ri territorial, mendimi publik ishte ngjeshur nga procesi jodemokratik i bisedimeve. Shumë politikolog dhe ekspertë ishin të mendimit se ligji i ri për kufijtë e komunave (Ligji për ndarje teritoriale) nuk shkon në përpuethshmëri të mundimeve për demokratizimin e Maqedonisë dhe repspektivisht është kontradiktorë me dizspozitën e marveshjes kornizë të Ohrit. Organizatat joqeveritare lokale shpejtë reaguan ndaj kufizimit të debatëve dhe vendimit

[1] Griçarska , Tamara, 2004. „Maqedonia nuk duhet ti anuloj zgjedhjet lokale “, Utrniski Vesnik, 15 korik viti 2004 .

autoritarë për procesin e decentralizimit. Për shembull, Analistët nga Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (QHKP) shpjeguan se ligji është sjell pa:

- Debatë të hapur publike për kufijtë e ri territorial të komunave:

- Konsulltime me administratorët lokalë të organizuara praën Bashkësinë e njësive të vetqqeverisjes lokale(ZELS)

- Marjen parasysh të pozicionit të partive opozitare;

- Marjen parasysh te nenit 3, STAV 2 nga Marveshja kornizë e Ohrit I cili thotë se " revizioni I kufijtë komunal do të zgjidhet nga ana e pushteti qendrorë apo lokal me pjesmarje ndërkombëtare.".“[2]
- Marjen parasysh se Maqedonia është nënshkruese dhe ka ratirfikuar POVELBA Evropjane për vetëqeverisje lokale në të cilët thuhet se " ndryshimet e kofijve të vetëqeverisjes lokale nuk mund të bëhen pa konsulltim të më parshëm me pushtetarët lokal, më anë të referendumit kur ajo është paraparë me statute" (neni 5).[3]
- Komiteti Maqedonas i Helsinkut "përkujtoj" se decentralizimi duhet ti kënaq nevojat dhe interesat e qytetarëve, dhe se "duhet të fillojë dhe të mbarojë me pjesmarje active të qytetarëve dhe më vullnetin e tyre të lirë". Mesazh të ngjajshëm erdhi dhe nga grupe tjera të organizatave joqeveritare, të cilat shprehën keqardhje për mënyrën autokrate të sjelljes së vendimeve për procesin e decentralizimit. Organizatat potencuan:

[2] Marveshja kornizë e Ohrit mund të gjendet në http://www.coe.int/T/E/Legal_affairs/Legal_co-operation/Police_and_internal_security/Police_cooperation/OHRID%20Agreement%2013august2001.asp

[3] Shqip prezentimin e QHKP në http://ëëë.crpm.org.mk/ALSPA%20conference.htm. Ndarja evropjanë për vetëqëveisje lokale mund të gjindet në http://www.lps.lv/Dokumenti/European_Charter_of_LocalSelf.htm

- “ Proceset që rezulltuan me propozim për ndarje teritoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën ishin jotransparente, pa respektimin e principeve të pjesmarësve, pa prezencë të publikut, pa çiltësi dhe sinqeritet ndaj qytetarëve, procese të cilat janë të demosdoshme gjatë këtyreve ndryshimeve të rëndësishme”( Qendra Maqedonse për bashkëpunim ndërkombëtarë,et al 2004).

Më tutje, vendimet konrete, siç është ajo të zmadhohet qyteti i Shkupit me inkuadrimin e Sarajit dhe Kondovës që krijon 21% popullatën Shqiptare në kryeqytet dhe inkuadrimin e fshtatrave shqiptar për reth në Strugë me çka Shqiptarët bëhen shumicë në komunë,janë në kundërshtim direct me këshillat e ekspertëve për organizimin e komunave, të cilat mendojnë se bashkëngjitja e fshatrave ndaj qyteteve e gulfatë zhvillimin e fshatrave.[4] Plani i komunës së Kërçovës e cila më vitin 2008 duhet të zmadhohet me inkuadrimin e fshatrave Shqiptare për reth është poashtu jopraktik sipas mendimit të ekspertëve për decentralizim që i potencuan rezultatet jiproduktive nga bashkëngjitjes së popullatës prej 30 000 njërëz të qytetit me të popullatë.të njëjtë.

Mendimet e ekspertëve poashtu treguan se 7 komuna në Maqedoni janë të zmadhuara në masë të tillë që ajo shumë seriozisht e rezikon mundësit për pjesmarje aktive të qytetarëve në procesin e sjelljes së vendimeve.[5]

Egzistojnë raste të cilat, sikur se mardhëniet etnike janë faktorë i vetëm që ndikon në vendimet për kufijtë e komunave dhe të cilët kanë plotësuar kriteriumet e njësime komunale të vëndosura nga vet Ligji për decentralizim. Në 13 rastet e tilla, kusht që komuna patjetër duhet të ketë më shum se 5000 banorë si do të mund të sigurojë resurse, të mjaftueshme ekonomike,

[4] Mendime të ndryshme për decentralizim dhe vetëqeverisje lokalemund të gjinden në Cangova, Katica. 2004. „Decentralizimi është vlerësuar si matematikë zgjedhore “. Utrinski Vesnik, 22 jqershorë, viti 2004.

[5] Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë, Raporti “Decentralizimi dhe zhvillimi mbajtur”, viti 2004

financiare dhe njerëzore për ti kryer nevojat e saja është dukshëm i paplotësuar. Dhe në fund, kishte dhe ankesë për ndryshimin e statusit të disa komunave të cilat për veç asaj se kanë kapacitet të funksionojnë sit ë tilla, e kanë humbur autonominë e tyre me qëllim të ndryshojnë përbërjen etnike të njësive tjera.[6]

[6] Ibid.

# Pyetjet më kontraverze dhe reakcionet e publikut

Pyetjet më kontraverze në Ligjin ishin të parashtruara me kufijnë e rinjë për komunat e Stugës, Kërçovës dhe Shkupit. Esenca e kufijëve të rinj ë Strugës dhe Kërçovës nga njëra anë dhe Shkupi nga ana tjetër janë të ngjajshme, por megjithatë të ndryshme. Maqedonasit janë të brengosur se do shkurtohet qasja deri tek resurset publike pasi që Struga dhe Kërçova do të bëhen komuna më shumë shqiptare. Shembujt e Gostivarit dhe Tetovës janë të mjaftueshëm që ti nxef frigën e maqedonasve nga Kërçova dhe Struga. Në Tetovë, pas demokratizimit të vendit në vitin 1991, qeverisja lokale ishte ndërmarë nga shqiptarët nga tetova dhe të gjithë Maqedonasit që ishin në vende udhëheqëse në institucionet publike në qytettin, ishin të ndëruar me shqiptarët etnik. E ngjajshme ishte edhe situate me filijalet e organeve qendrore dhe ministrive. Maqedonasit nga regjioni frigohen se dominimi i Shqiptarëve në sektorin public do të bëj situatën e tyre ekonomike të rezikshme dhe do ti detyroj të emigrojnë në Shkup ose jashtë. Nga ana tjetër, Shqiptarët lokal janë të brengosur se në kufijtë e vitit 1996 të ngelin, sferat ku ata jetojnë masovikisht në numër të madh sikur në Zajas dhe Veleshtë, do të ngecin të pazhvilluara dhe pa qasje ne resurset publike.[7]

Shkupi, nga ana tjetër, është qyteti kryesorë dhe çështja për dygjuhësinë i tangon si dhe qasja në resurset publike deri tek resurset publike dhe shërbimet në gjuhën amtare, si dhe statusi simbolik i qytetit. Maqedonasit frigohen jo vetëm për atë se resurset e qytetit do të harxhohen në ofrimin e shërbimeve të gjuhës shqipe, por poashtu edhe nga humbja e indentitetit maqedonas të kryeqytetiti. Kryeqyteti ka simbolikë të rëndësishme për dy grupet dhe nëse Shqiptarët e shkupit nuk kanë qasje në resurset publike në

[7] Shiqo studimin „Fshati I Ali Ahmetit " e bërë nga ekspertë udhëheqës për Ballkanin, Inicijativa për Stabilitet Evropjan: http://www.esiweb.org/docs/shoëdocument.php?document_ID=36

gjuhën e tyre amëtare, ajo është çështje e rëndësishme në ndërtimin e realitetit të ri në Maqedoni e bazuar në marveshjen kornizë të Ohrit.

Shoqëria Maqedonase e provokuar dhe masovikisht e përkrahu inicijativën e kongresit botërorë maqedons për mbajtjen e referendumit për kufijtë e rinj të komunave. Inicijativa poashtu ishte përkrahur nga partija kryesore opozitare VMRO-DPMNE. Kjo parti orgnizonte një vazhdimësi protestash prej të cilave më i madhi ishte mbajtur më 27 korrik në Shkup ku reth 20 mijë njerëzu mblodhën që ti kundërshtojnë propozimet për ndarje teritoriale. Respektivisht, qytetarë nga gjitha shtresat të shoqërisë e shprehen qendrimet negative në lidhje ndryshimet e propozuara për kufijtë e komunave dhe ç1 komunat nga 123, bashkësitë komunale orgnizuan referendum lokal, duke shprehur vullnetin e tyre për ruajtjen kufijve e vetëqeverisjes lokale dhe paknaqësia e ligjit të ri. Madje dhe komunat nga Shqiptarë maqedonas dhe Turq maqedonas mbajtën referendum për këtë çështje.

Referendumet që e kundërshtuan ligjin e ri ishin të sukseshëm në komunën e Labunishtës, kryesisht e populluar me Shqiptarë, Maqedonas(kryesisht Maqedonas Musliman) dhe Turq, Komuna Centar Zhupa, komunë ku shumica deklarohen si etnik Turq, me shume Maqedonas dhe Shqiptarë (kjo komunë masovikisht (95%) votoj kundër shpërndarjes së komunës së Dibrës), komuna Rostushe (ku qytetarët kundër bashkëngjitjes me Mavrovën, Kryetari i Komunës Durmishi e përshkruajti ligjin e ri sikur vendim “I përshpejtuar” dhe pa “argumentim të mjaftueshëm”. Shqiptarët lokale nga Negotina-Pologu, Xhepçishte dhe Bogovinje e shprehen paknqësinë e tyre me ligjin e ri nëpërmjet padëgjueshmëri publike me bllokimin e rrugëve lokale. Brengosja e Turqve etnik në komunat Vrapçishtë dhe Banjicë është poashtu evidente.Të gjitha këta shembuj tregojnë se kundërshtimi e ligjit për shpërndarje nuk ishte bazuar në bazë etnike por se ka dimenzioni lokale dhe multietnike..

## Reakcionet e bashkësisë ndërkombëtarë dhe dështimi i referendumit

Megjithatë bashkësia ndërkombëtare ishte e mendimit tjetër. Në sprovim të asaj se shum mvareshte nga ligji i ri dhe mundësia që situata të bëhështe kritike në qoftë se rezulton referendum i sukseshëm me çka de facto do ta kishte kthyer vendin në status quo ante, bashkësia ndërkombëtare u mundua të ndikojë në rezultatet. Bashkimi Evropjan nuk mundeshte direkt të kritikojë të drejtën themelore demokratike , e drejta për mbajtjen e referendumit, për atë kërkojë nga qytetarët të mendojnë për lidhëshmërinë e inkuadrimit të Maqedonisë në BE dhe implementimin e marveshjes me referendumin.. Mundësia për referendum të sukseshëm ishte përcjellur si hap mbrapa në implementimin e marveshjes dhe, e barabartë si hap më larg nga integrimi evropjan. Nga aty, derisa Maqedonasit e kishin zgjidhjen për të dalur dhe të votojnë në referendum, sipas përfaqësuesit të BE, dilemma para qytetarëve ishte integrim apo izolim, a gjatë shfaqjes së dytë Maqedonia do të do ishte sjellur në një "gropë e zezë" e izoluar së bashku me Sqipërinë, Kosovën, Sërbinë dhe Malin e Zi.[8] Me shfrytëzimin e përkrahjes nga BE dhe shfrytëzimi e pyetjes retorike për zgjedhje ndërmjet të kaluar dhe të tanishmen, integrim apo izolim, Qeverija e promovonte idenë se çështja e referendumit „ nuk meriton përgjigje "[9] dhe bëntë shtupje qytetarëve të mos votojnë në referendum.

Qëndrimi i Shtëteve të Bashkuar të Amerikës ishte në përpuethshmëri me dekklaratat e BE. Një diplomat i vjetër amerikan paralajmëroi se refuzimi i ndarjes së re teritoriale në Maqedoni do të „ishte kundër fjalët dhe frymën e

[8] Dunjakк, Gordana. 2004. „ Maqedonia nuk duhet tëshoj trenin për hyrje në BE ", Utrinski vesnik, 4. nëntor viti 2004.
[9] Sllogan I kmapnjës masovike nga bilboardët në

marveshjes së ohrit.“[10] Zavendës sekretari shtetërorë Amerikan për çështje politike Mark Grosman ishte më dramatik, duke deklaruar se referendumi i ardhshëm është „zgjidhje ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes.“[11] Duke shfrytëzuar metodën e „ karotës dhe pjeshkës “ në ndihmë, SHBA poashtu prmetuan 9,5 milojon dollarë për ndihmë dhe realizimin e programës për decentralizimin e Maqedonisë.[12]

Përkrah orvajtjeve të bashkësisë ndërkombëtare dhe Qeveria të ndikojnë në votuesit, rezultatet e disa anketave të bëra nëpërmjet medioumeve për referendumin treguan se disponimi i përgjithshëm tek qytetarët është se ata do të votonin dhe referendumi mund të ketë sukses Anketat telefonike te Brima –Gallup treguan se 63% nga qytetarët do të kishin votuar dhe prej atyre 74% me vënjen përsëri të ligjit nga 1996 për ndarje teritoriale. Nga pjesmarësit në anketë, 47,8% mendonin se referendumi do te jetë i sukseshëm kurse 33% besonin se aj do të jetë i pasuksesshëm. Hulumtimi i përkrahur nga LSDM tregoj se nga 1200 të pyetur, mbi 50% do të kishin përkrahur referendumin dhe se shumica do të kishte në përfitim të vënjës përsëri të ligjit për ndarje tëritoriale nga vitit 1996 (vota „për“). Anketë tjetër e shpallur në „Vreme “ tregoj se 64,6% nag të pyeturit janë përgjigjur se do të marin pjesë në referendum kurse vetëm 51,4% do të kishin votuar „për“. Këta rezultate të anketave që tregojnë se tendencioni i përgjithshëm ka qenë për pjesmarje dhe votim “për”, duhet të shiqohen në aspektin e kohës-tajmingut, posaçërisht me fillimin kampanjës së përbashkët për pro referendumit të opozitës maqedonase dhe Kongresi botërorë maqedonas.

SHBA, ndoshta janë të brengosur nga këto anketa, e pranuan Maqedonin nën emrin e saj kushtetues – Republika e Maqedonisë, vetëm dy ditë para se të mbahet referendumi. Njohja nga ana e e një nga anëtart më ndikues të OKB

[10] Shiqo *Тајмс për Evropën Juglindore*. „SHBA të brengosur për referendumin maqedonas “, 17 shtatorë viti 2004 (*Southeast European Times*. “US Voices Concern Over Macedonia Referendum”, 17 September, 200ç.)
[11] Shqio Tjms *për Evropën Juglindore*. „Prodi dorëzon pyetësorine BE qeverisë Maqedonase “, 3 Tetorë, viti 200ç . (*Southeast European Times.* “Prodi Gives EC Questionnaire to Macedonian Government”, 3 October, 200ç.)
[12] Ibid.

nën emrin kushtetues ishte komentuar si shenjë se të tjerët do të përcjellin shmebullin e SHBA dhe ishte e përcjellur si eufori ndërmjet qytetarëve Maqedonas. Administrata e Bushit e shpjegoj njohjen si hap ndaj „ stabilizimit “ e vendit dhe parashikoj se shum do ti zgovloj shansat për sukses të referendumit. Shumë analist politik vërtetojnë se ndikim më të madh për sjeljen e votuesve ishte vendimi i Qeverisë së SHBA të pranojë Maqedoninë nën emrin kushtetues pred vet referendumit. Bashkësia ndërkombëtare ishte në mënyrë direkte e përgjegjshme për rënjën drastike të entuziazmit tek maqedonasit të votojnë për referendumin. Nga kjo 436 202 prej 1 709 536 qytetarë dolën të votojnë më 7- nëntorë të vitit 2004, dhe 50+1% shumicë e nevojshme për votim që referendumi të jetë i suksesshëm as për së afërmi nuk ishte aritur. BE dhe SHBA e lavdëruan „mençurinë “ e qytetarëve maqedonas që kanë apstenuar nga pjesmarja në referendum dhe kanë drejtuar Maqedoninë në rrugën ndaj stabilizimit dhe integrimeve Euro-atlantike.

# Përfundim

Decentralizimi është nje nga argumentet kryesore të demokracisë për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut. Të sigurohen njësi të afta të vetëqeverisjes lokale në Maqedoni, principi i decentralizimit, ishte përmbajtur nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale, Ligji për ndarje teritoriale të vetëqeverisjes lokale. Ligji për vetëqeverisje lokale ishte drejtuar ndaj transferit të ingerencave në vetëqeverisjen lokale mbi aspektet e rëndomta nga jeta publike ( përmirësimin e rrugëve, kanalizimin ndryçimet rrugore etjerë.) dhe inkuadrimi e ingerencave nga sfera e arsimit, kulturës, shëndetësisë dhe ambienti jetësorë. Nga ana tjetër, Ligji për financimin e vetëqeverisjes lokale duheshte të ofrojë mundësi për zbatimin e këtyre funksioneve të reja nëpërmjet decentralizimit fiskal dhe redistribuimit. Roli i Ligjit për ndarje teritoriale duheshte shqyrtohet në këtë kontekst dhe qëllimi i tij duheshte ti ishte regullimi madhësisë dhe konfigurimi komunave me qëllim të sigurohet kapacitetit i tyre i nevojshem për për zbatimin e funkcioneve të tyre.

Decentralizimi në Maqedoni duhet ti ketë marë parasysh kriteret ekonomike, gjeografike, ato të infrastrukturës dhe mundësi për zhvillim. Në Maqedoni, këta kriteriume ishin të kërcnuara nga problemet etnikedhe përgjigjet politike ndërmjet partnerëve të koalicionit. Nga rundi i parë i debatëve, partitë politike, në kundërshtim me logjikën komplekse të procesit të decentralizimit, i morën parasysh dhe i treguan ndryshimet e njësive të vetëqeverisjes lokale vetëm në aspekt etnik i cili është kryesorë për plotësimin e Marveshjes kornizë të Ohrit.. Ky ligj ishte/është hapi më i rëndë në implementimin e Marveshjes Kornizë të Ohrit nga viti 2001 i cili e nxori Maqedoninë nga kulmi i luftës qytetare. Ligji për ndarje teritoriale duheshte të jetë triumf nga aspekti politik në regjion ku politikanët shpeshëherë kanë qenë të mashtruar nga nacionalizmi.Ligji i aprovuar nga Qeveria nuk është

triumf i tillë..Për fat të keq, bashkësia ndërkombëtare në masë të madhe u mbajtë mbrapa pozicionit të Qeverisë në raport me ligjin e rid he referendumin gjatë asaj duke përkrahur politikë jot ë mirë dhe duke vënë Qeverinë në pozitë të vështirë  vis-à-vis shumicën në vend.

Mobilizimi i publikut në lidhje me këtë pyetje në mënyrë të panevojshme e largoj vëmendjen nga problemet më të rëndësishme më të cilët ballafaqohet vendi, gjendja e ekonomisë dhe integrimi më Bashkimin Evropjan. Deklaratat e ndryshme nga lideret pro-kampanjës për referendum vërtetojnë se praën përkrahjes së plotë të Marveshjes kornizë së Ohrit dhe decentralizimit të vendit, opozita do të ketë dëshirë të shof ligjë të mirë të pregaditur të vetëqeverisjes lokale duke marë parasysh si prespektivat lokale dhe ndërkombëtare si dhe vullnetin dhe nevojat e të gjithë qytetarëve pa marë parasysh përkatësinë e tyre nacionale. Decentralizimi duhet fillojë me pjesmarje active të qytetarëve dhe me vullnetin e tyre të lirë.